

Raport Mujor për fondin Credins Pension

Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension synon optimizimin e kthimit nga investimi duke minimizuar riskun, me qëllimin për t'u siguruar anëtarëve të Fondit të ardhura më të larta dhe të sigurta në moshën e pensionit. Portofoli i Fondit Credins Pension, do të përbëhet kryesisht nga obligacione afatgjata të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të denominuara në Lek, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë.

Data e raportit: 30.11.2022

Informacion për Fondin

Shoqëria Administruese e Fondit:	Credins Invest
Data e lançimit të fondit:	01 Janar 2012
Monedha e Fondit:	Lek

Fondi i adresohet investitorëve që kërkojnë një cilësi jete gjatë pensionit e cila nuk rezulton më e ulët sesa faza përpara daljes në pension.

Profili i rrezikut dhe përfitimit

Ecuria e normës së kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të Republikës së Shqipërisë. Historikisht këto norma kanë treguar luhatshmëri të ulët.

Rrezik i ulët	Rrezik i lartë					
Përfitimet tipike më të ulëta	Përfitimet tipike më të larta					
1	2	3	4	5	6	7

Fondi Credins Pension ka një profil rreziku në nivelin 1, pra risku më i ulët.

Të dhëna kryesore për Fondin

Vlera Neto e Aseteve	1,660,022,515.09
Çmimi i kuotës	1,612.9954
Numri i investitorëve	18,734
Kthimi nga investimi (30.11.2021 - 30.11.2022)*	3.38%

* Tarifa e administrimit është zbritur përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.

Karakteristikat e rrezikut të asetëve në Fond

Depozitat Bankare

Depozita Bankare si klasë asetë përmban rrezikun e kredisë së bankës dhe rrezikun e rreçimit në momentin e maturimit të saj.

Rreziku i rreçimit nënkupton uljen e normës së interesit kur depozita rivendoset me të njëjtin maturitet.

Obligacionet dhe Bonot Qeveritare

Këto asetë janë të emetuara nga Qeveria agjencitë apo ndërmarrje të sponsorizuara nga Qeveria. Megjithatë, qeveritë nuk garantojnë pagesën e interesit apo principalit. Obligacionet apo Bonot qeveritare janë subjekt i rrezikut nga normat e interesit dhe kanë nota krediti ("rating") të ndryshme. Bonot përmbajnë rrezik nga interesat më të lartë se obligacionet me të njëjtën kohë deri në maturim.

Kostot dhe Pagesat


Pagesat përdoren për të paguar kostot e administrimit të Fondit, duke përfshirë kostot e marketingut dhe shpërndarjes së kuotave të Fondit. Pagesat që kryhen çojnë në ulje të rritjes potenciale të investimit.

Pagesa e hyrjes	0%
Pagesa e daljes	0%
Pagesa vjetore	Tarifa e Administrimit 2% në vit e Vlerës Neto të Aseteve
Kosto transaksioni	0%
Tarifa e performancës	0%


Shpërndarja e Instrumenteve si përqindje e Aseteve Totale

Shpërndarja e Instrumentave	ALL	%Aseteve
Obligacione	1,652,519,091.11	99.36%
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	10,589,435.69	0.64%

Shpërndarja e Instrumenteve sipas Llojit



Kthimi vjetor neto historik



Nisur nga natyra afatgjatë e fondit të pensionit, asetet mbahen kryesisht deri në maturim dhe për rrjedhje çmimi i kuotës nuk pëson luhajtje të konsiderueshme.


Fondi Credins Pension, përgjithësisht, nuk është ndikuar nga luhajtjet e vazhdueshme të normave të interesit të obligacioneve qeveritare gjatë vitit 2022.

Ankandet e titujve qeveritarë dhe normat e interesit

Qeveria e Republikës së Shqipërisë emeton letrat me vlerë në periudha relativisht të rregullta dhe të shpeshta.

Në përputhje me materialet informuese të publikuara nga Ministria e Financave, duke përjashtuar ankandet e obligacioneve 2-vjeçare të cilat zhvillohen një herë në muaj, ankandet e obligacioneve të tjera (3,5,7,10, 15-vjeçare) zhvillohen me një frekuencë të përafërt prej 3 muajsh.

Ecuria e yield-eve të Obligacioneve



Ankandi i obligacionit 15-vjeçar, ri-hapje, në datë 22 nëntor, rezultoi me rritje nga 8.39% që ishte në shtator në 8.95%. Gjatë muajit nëntor nuk u zhvilluan ankande për obligacionet 7-vjeçar dhe 10-vjeçar. Rritja e normave të interesit të obligacioneve afatgjata ka ndikim pozitiv për anëtarët e Fondit, pasi kontributet e tyre investohen me norma kthimi më të larta, gjë që rezulton në kthim më të lartë për Fondin në afat të gjatë.

Performanca e kaluar nuk është një udhëzues, premtim apo garanci për performancën e ardhshme dhe nuk duhet të jetë faktori i vetëm i shqyrtimit gjatë zgjedhjes së një produkti. Të gjitha investimet financiare përfshijnë një element të rrezikut. Prandaj, vlera e investimit tuaj dhe të ardhurat nga ajo do të ndryshojnë. Nivelet dhe bazat e taksimit mund të ndryshojnë herë pas here. Për informacion shtesë, jeni të ftuar të lexoni Prospektin e Fondit si dhe të vizitoni faqen zyrtare të shoqërisë www.credinsinvest.com